



SHTOJCË

MBI MODIFIKIMIN DHE NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE STANDARTE TË TENDERIT

Sot më datë 26.11.2018, Njësia e Prokurimit ju bën me dije se:

Në bazë të Nenit 63 pika 1.1, të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78, pika 4, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), procedura e Hapur e prokurimit me objekt: **”Rruga për në fshatin Kasallë (Degëzim nga Cerkezi ne Cinam) Loti II”** me fond limit: **45.365.872** (dyzetë e pesë milion e treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës në mbështetje të VKB Nr. 132 datë 21.12.2017, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2018”, është pezulluar si rezultat i paraqitjes së një ankimi në lidhje me Dokumentat Standarte të Tenderit.

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, ka ndjekur të gjitha procedurat ligjore në lidhje me trajtimin e ankimit dhe ka konkluduar me mospranimin e tij. Në vijim, Bashkia Tiranë ka respektuar afatin ligjor për kundërshtimin e vendimit të Autoritetit Kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktor, në mbështetje të Nenit 42, pika 2 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut VII, Neni 62, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), me nismën e vet, vendosi të bëjë ndryshimet në dokumentat e tenderit përmes hartimit të një Shtojce, e cila u komunikohet menjëherë të gjithë Operatorëve ekonomikë në rrugë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik duke u bërë detyruese për ta.

Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, vendosi të bëjë ndryshimet përkatëse në Dokumentat Standarte të Tenderit për procedurën e prokurimit me objekt **”Rruga për në fshatin Kasallë (Degëzim nga Cerkezi ne Cinam) Loti II”** si më poshtë vijon:

1. Në pjesën Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, *pika 2.2, 2- Kapaciteti Financiar*, ndryshohet si më poshtë:

ISHTE:

2. Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2015, 2016, 2017) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet te jete jo me e vogel se 50% e vlerës së fondit limit perkatesisht: **45,365,872** (dyzetë e pesë milion e treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH

BËHET:

2. Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2015, 2016, 2017) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet te jete jo me e vogel se 50% e vlerës së fondit limit perkatesisht: **22,682,936** (njetetë e dy milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë)

Ju lutemi Operatorëve ekonomikë që do të paraqesin ofertat e tyre për këtë procedurë të marrin për bazë Shtojcën mbi modifikimin dhe ndryshimin e Dokumentave Standarte të Tenderit në platformën elektronike të APP –së.

Nisur nga ky fakt, Njësia e Prokurimit në mbështetje të Nenit 42 pika 2/1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe në bazë të Kreut VII , Neni 62 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), vendosi të zgjasë afatin kohor për dorëzimin e ofertave me 5 (pesë) ditë kalendarike.

Gjithashtu duke qenë se afati kohor për ankimim në Komisionin e Prokurimit Publik në lidhje me pretendimet e ngritura nga Ankimuesi ka përfunduar, në mbështetje të Nenit 63, pika 4 të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78, pika 6, gërma “d” të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Njësia e Prokurimit vendosi të zgjasë afatin kohor për dorëzimin e ofertave aq ditë kalendarike sa ka zgjatur periudha e pezullimit me 17 (shtatëmbëdhjetë) ditë kalendarike.

Duke përfshirë zgjatjen e afatit si rezultat i ndryshimit të dokumentave të tenderit si dhe duke përfshirë peridhën kohore të pezullimit, afati kohor për dorëzimin e ofertave zgjatet me 22 (njëzetë e dy) ditë kalendarike në total. Njësia e Prokurimit njofton të gjithë Operatorët ekonomik pjesmarrës se afati kohor për dorëzimin e ofertave për procedurën e prokurimit me objekt: “**Rruga për në fshatin Kasallë (Degëzim nga Cerkezi ne Cinam) Loti II**” është si më poshtë vijon:

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 26.12.2018, Ora: 11:00

Vendi: Në faqen zyrtare të Web-it të APP-së, www.app.gov.al

Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 26.12.2018, Ora: 11:00

Vendi: Në faqen zyrtare të Web-it të APP-së, www.app.gov.al

